



Datë: 12.06.2025
Numër Protokolli: 4191/2025

A.nr.325/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.325/2025, të datës 18.02.2025, të parashtruar nga ankuesi L.J, kundër organit të punësimit: Këshilli Prokurorial i Kosovës, në çështjen juridike “*Vlerësim i Rezultateve në Punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 12.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.325/2025, të datës 18.02.2025, e parashtruar nga ankuesi L.J, në atë mënyrë që **anulohet** Formuari lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2024.

II. Obligohet Udhëheqësi i Divizionit për Shërbime të Përgjithshme në Këshillin Prokurorial të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë rivlerësim të rezultateve në punë për ankuesin për periudhën, nga data 01.01.2024 deri me 10.08.2024.

III. Obligohet Udhëheqësi i Divizionit për Siguri dhe Transport në Këshillin Prokurorial të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë rivlerësim të rezultateve në punë për ankuesin për periudhën, nga data 11.08.2024 deri me 31.12.2024.

IV. Obligohen Drejtorit i Përgjithshëm dhe Udhëheqësja e Divizionit për Staf Administrativ të Këshillit Prokurorial të Kosovës, që të ndërmarrin çdo veprim administrativ në kuptim të zbatimit të këtij vendimi sikurse është përcaktuar në pikën II dhe III të këtij dispozitivi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, L.J (*tutje referuar: Ankuesi*), më datë 18.02.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të regjistruar nën shenjë A.nr.325/2025, kundër vlerësimit të rezultateve të punës të vitit 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar: Këshilli*), bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 24.03.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit*), vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1068/2025 të datës 18.02.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokument identifikimi; Formulari për vlerësimin e rezultateve të punës i vitit 2024; Planin e personelit të stafit administrativ për vitin 2024; Përgjigjen në ankesë të datës 24.03.2025; Akt emërimit me Nr.1453/2024 të datës 01.08.2024; Akt emërimit Nr.1467 të datës 01.08.2024; E-mailin e datës 21.03.2025; Përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me numër protokolli 97/2025; Vendimin me numër protokolli 2088/2024; Vendimin me numër protokolli 1704/2024 të datës 16.10.2024; Vendimin A.nr.2085/204 të datës 29.01.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi është i punësuar në Këshillin Prokurorial të Kosovës, respektivisht i njëjti sipas Akt emërimit me Nr.1453/2024 të datës 01.08.2024, ushtron pozitën e punës *Zyrtar për Operativ dhe Siguri*, pranë Divizionit për Siguri dhe Transport të Departamentit për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se Udhëheqësi i Divizionit për Siguri dhe Transport, i caktuar Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Departamentit për Shërbime të Përgjithshme në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Vendimit DPSKPK/Nr.630/2024 të datës 09.12.2024 dhe atë për një periudhë dy (2) mujore (16.12.2024-15.02.2025), ka bërë vlerësimin e rezultateve të punës të ankuesit për periudhën për tërë vitin 2024, duke e vlerësuar të njëjtin me notën e përgjithshme 3.61. Ankuesi, ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve të punës të vitit 2024, e mbështet në Ligjin Nr.06/L-144 për Zyrarët Publik, duke theksuar se z. F.S, gjatë tërë vitit nuk ka qenë mbikëqyrës i tij i drejtpërdrejtë, dhe i cili sipas ankuesit asnjëherë nuk e ka ftuar apo takuar të njëjtin siç parashihet me nenin 8 të Rregullores Nr.10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Stafit Administrativ të Sistemit Prokurorial.

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit në pikëpamje të kompetencës lëndore të Këshillit për vendosje lidhur me këtë çështje administrative, ju referua nenit 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrarët Publik, i cili përcakton se: “4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”, si dhe nenit 52 (Vlerësimi i rezultateve në punë) paragrafit 19 të këtij ligji, i cili përcakton se: 19. Rregullat për zbatimin e këtij neni për nëpunëset/it në Presidencën e Republikës së Kosovës,

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Sistemin e Drejtësisë, Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe institucionet e pavarura kushtetuese, rregullohet me këtë ligj dhe me akt të veçantë të miratuar nga organet kompetente të këtyre institucioneve.; kështu që, nisur nga ky referim ligjor rrjedh së të punësuarit në administratë të Këshillit Prokurorial të Kosovës, kanë statusin e nëpunësit civilë më status të veçantë dhe së mbi këtë bazë ligjore Këshilli Prokurorial i Kosovës, me akt të veçantë ligjor ka rregulluar procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës të stafit administrativ në këtë institucion gjegjësisht me Rregulloren Nr.10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Stafit Administrativ të Sistemit Prokurorial.

Andaj, Kolegji i Këshillit, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuesit dhe vendosjen e kësaj çështje juridike administrative ju referua dispozitave të Rregullores Nr.10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Stafit Administrativ të Sistemit Prokurorial, me theks të veçantë:

- Nenit 1, I cili përcakton se: *Kjo rregullore përcakton kriteret dhe procedurat per vlerësimin e rezultateve ne pune te stafit administrativ ne sistemin prokurorial te Republikës së Kosovës.*

- Nenit 2, paragrafit 1 i cili përcakton se: *Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen ndaj tërë stafit administrativ të sistemit prokurorial të Republikës se Kosovës.*

- Nenit 4, ku përcaktohet se: *Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 1.realizimin e objektivave te përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave te punës ne përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe sistemit prokurorial, si dhe kryerjen e detyrave të tjera të caktuara nga udhëheqësi i drejtperdrejte; 2.aftësitë profesionale dhe aftësitë personale te shfaqura nga stafi administrativ gjatë ushtrimit te detyrës.*

-Nenit 7, paragrafi 1, paragrafit 2 nën paragrafi 2.1 , ku përcaktohet se: *1 . Procedura e vlerësimit të rezultateve në pune zhvillohet me plotësimin e formularit të vlerësimit, me zhvillimin e intervistës se vlerësimit dhe me konfirmimin e rezultatit të vlerësimit. 2.Vlerësimi i rezultateve në punë të stafit administrativ bëhet për periudhat periodike si ne vijim: 2.1. Stafit administrativ qe ka akt emërimi të përhershme, periudha e vlerësimit është një (1) vjeçare, e cila fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor, ndërsa vlerësimi bëhet deri ne diti: n e fundit te muajit shkurt te vitit pasues per vitin paraprak;*

-Nenit 10, ku përcaktohet se: *Udhëheqësi, së paku një here gjate periudhës vlerësuese dhe/ose, sa here që e vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me stafin administrativ për të rishikuar progresin e bërë ne arritjen e objektivave ta përcaktuar, sjelljet profesionale dhe për dhënien e sugjerimeve për përmirësime te nevojshme.; si dhe,*

-Nenit 12, ku përcaktohet se: *1.Vlerësimi i rezultateve në punë të stafit administrativ mund të realizohet edhe jashtë periudhës së vlerësimit, në rast të: dorëheqjes, transferimit, pezullimit, shkarkimit apo përfundimit të marrëdhënies së punës. 2. Stafit administrativ, të cilit i është konfirmuar pozita e punës ne sistemin prokurorial, pas kalimit të punës provuese, vlerësohet për pjesën e mbetur te vitit kalendarik ne pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe duke marre parasysh edhe vlerësimin e punës provuese. 3. Nëse vlerësuesi, Jep dorëheqje, transferohet, avancohet apo arrin moshën e pensionimit, ai është i detyruar që ta bëjë vlerësimin e vartësve te tij jashtë periudhës se vlerësimit, ndërsa vlerësimin për periudhën e mbetur deri në fund të vitit, e bën vlerësuesi pasues.*

Në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit dhe nga analizimi i shkresave të lëndës, konstatohet se Udhëheqësi i Divizionit për Siguri dhe Transport, dhe nga data 16.12.2024 i caktuar Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Departamentit për Shërbime të Përgjithshme në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës, ankuesin e ka vlerësuar për tërë vitin 2024 dhe atë me notën e përgjithshme 3.61, që sipas nenit 9 nën paragrafit 2.4 të Rregullores Nr.10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Stafit Administrativ të Sistemit Prokurorial, nota nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton *"tejkalon pritshmëritë"*, dhe sipas paragrafit 3.2, është përcaktuar se: *"tejkalon pritshmëritë" - vlerësohet stafi administrativ, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të njësisë përkatëse;* mirëpo duke marrë parasysh se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit A.nr.880/2024 të datës 05.08.2024, kishte konstatuar se ankuesi sipas Akt emërimit me numër DBNJ/DSKPK/-665/2019 të datës dhe përshkrimit të detyrave të punës, i kishte raportuar drejtpërdrejtë Udhëheqësit të Divizionit për Shërbime të Përgjithshme në SKPK, në këtë kuptim rrjedhë se ankuesi gjatë vitit 2024 ka pasur dy mbikëqyrës të drejtpërdrejtë, gjegjësisht nga data 01.01.2024 deri më 10.08.2024, Udhëheqësin e Divizionit për Shërbime të Përgjithshme, ndërsa nga data 11.08.2024 apo nga lëshimi/fillimi i Aktit të emërimit me numër Nr.1453/2024 të datës 01.08.2024, rezulton se i njëjti i raporton drejtpërdrejtë Udhëheqësit të Divizionit për Siguri dhe Transport, dhe si për rrjedhojë, Kolegji i Këshillit, konstaton se me këtë rast është vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartë theksuara të Rregullores Nr.10/2024 për Vlerësimin e Rezultateve të Punës të Stafit Administrativ të Sistemit Prokurorial, ngase në rastin përkatës rezulton se ankuesi gjatë vitit 2024 ka pasur dy mbikëqyrës të drejtpërdrejtë, ndërsa është vlerësuar vetëm nga Udhëheqësi i Divizionit për Siguri dhe Transport (Ushtruesi i Detyrës i Udhëheqësit të Departamentit për Shërbime të Përgjithshme).

Andaj, duke qenë se ankuesi për vitin 2024 ka pasur dy mbikëqyrës të drejtpërdrejtë, përkatësisht nga data 01.01.2024 deri më 10.08.2024, Udhëheqësin e Divizionit për Shërbime të Përgjithshme, ndërsa nga data 11.08.2024 deri më datë 31.12.2024, si mbikëqyrëse e ankuesit ka qenë Udhëheqësi i Divizionit për Siguri dhe Transport, kurse ankuesi siç u theksua edhe më sipër se është vlerësuar vetëm nga ky i fundit për vitin tërë vitin 2024, Kolegji më qëllim të kthimit të ligjshmërisë e në kuptim të dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.325/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit L.J;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqëses së Divizionit për Staf Administrativ të Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.